



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. dokumentit:22.6.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
PEJËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
2 Opinioni i auditimit	9
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar	10
4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	11
5 Pasqyrat financiare - Pajtueshmëria me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit.....	13
6 Menaxhimi Financiar	15
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	15
6.2 Shpenzimet	19
6.3 Pasuritë	21
6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	22
7 Kontrolli mbi menaxhimin	23
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	23
7.2 Auditimi i Brendshëm	24
8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Pejës	25
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	26
Shtojca II. Rekomandimet e vitit të kaluar	28

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr. 03/L-241 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011
MF	Ministria e Financave
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të:

Në pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit neni 13 i PVF, Komuna e Pejës ka prezantuar të hyra të realizuara prej 3,293,000€, dhe në shënimin 15 janë prezantuar si të hyra vetjake 2,480,000€ ndërsa kjo shumë duhet të jetë 2,604,370€.

(SNISA 400: *Opinion i Kualifikuar*).

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e prezantuara tek shpalosjet e të hyrave vetjake, pasuritë fikse, stoqeve dhe llogarive të arkëtueshme nuk ishin të sakta. Pasaktësitë janë si në vijim:

- Te shënimin 15 janë prezantuar si të hyra vetjake 2,480,000€ ndërsa duhet të jetë 2,604,370€;
- Te shënimin 30: Përmbledhja e pasurive jo financiare edhe pse është shpalosur vlera prej 6,579,000€ , kjo shumë nuk është e saktë sepse Komuna e Pejës ende nuk është në gjendje të nxjerrë vlerën e tokës, ndërtesave dhe infrastrukturës;
- Ne shënimin 32 Përmbledhja e stoqeve në fund të periudhës, nuk ishte prezantuar asnjë vlerë në PVF;
- Në shënimin 34 Komuna e Pejës ka prezantuar si të arkëtueshme nga tatimi në pronë vlerën 323,000€, ndërsa sipas raporteve të MF, të marra nga departamenti i tatimit në pronë, të arkëtueshme nga tatimi në pronë janë 6,852,822€; dhe
- Në shënimin 35 Komuna e Pejës ka prezantuar të hyra vetjake të pa shpenzuara në fund vitit vlerën prej 648,000€, ndërsa duhet të jetë 699,690€.

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm është se Komuna e Pejës nuk ka arrit të ndërtoj një strukturë të konsoliduar të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi. Ne duhet të theksojmë faktin se Komuna e Pejës në dy vitet e fundit nuk ka adresuar asnjë nga

rekomandimet tona dhe ne jemi të brengosur për një qasje të tillë. Menaxhmenti i komunës duhet të zhvilloj një qëndrim më pozitiv ndaj kontrolleve të brendshme të organizatës.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroi:

- Forcimin e kontrollit të brendshëm;
- Që të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi të adresohen dhe të pasohen me masa adekuate të veprimit;
- Përmirësime të mëtutjeshme të performancës buxhetore;
- Harmonizimin e të hyrave vetjake;
- Se procedurat e prokurimit zhvillohen konform rregulloreve të prokurimit dhe të forcohen kontrollet e monitorimit të kontratave ;
- Shpalosjen e të gjitha llogarive të arkëtueshme;
- Shpalosjen e të gjitha obligimeve të komunës;
- Regjistrat e plotë për pasurinë e komunës;
- Një rishikim funksional të kontrolleve të brendshme; dhe
- Ta themeloj Komitetin e auditimit.

Menaxhmenti i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi PVF për vitin 2011, dhe është zotuar që do t'i bëj të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës të përgatisë PVF sipas kërkesave të Rregullës Financiare 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Pejës.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Pejës. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme, Pasqyrat Financiare nëntë mujore si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në PVF, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF të Pejës janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të Komunës së Pejës, SNISA përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën I.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të:

Në pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit neni 13 i PVF, Komuna e Pejës ka prezantuar të hyra të realizuara prej 3,293,000€, dhe në shënimin 15 janë prezantuar si të hyra vetjake 2,480,000€ ndërsa kjo shumë duhet të jetë 2,604,370€.

(SNISA 400: *Opinion i Kualifikuar*).

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e prezantuara tek shpalosjet e të hyrave vetjake, pasuritë fikse, stoqeve dhe llogarive të arkëtueshme nuk ishin të sakta. Pasaktësitë janë si në vijim:

- Te shënimin 15 janë prezantuar si të hyra vetjake 2,480,000€ ndërsa duhet të jetë 2,604,370€;
- Te shënimin 30: Përmbledhja e pasurive jo financiare edhe pse është shpalosur vlera prej 6,579,000€ , kjo shumë nuk është e saktë sepse Komuna e Pejës ende nuk është në gjendje të nxjerrë vlerën e tokës, ndërtesave dhe infrastrukturës;
- Ne shënimin 32 Përmbledhja e stoqeve në fund të periudhës, nuk ishte prezantuar asnjë vlerë në PVF;
- Në shënimin 34 Komuna e Pejës ka prezantuar si të arkëtueshme nga tatimi në pronë vlerën 323,000€, ndërsa sipas raporteve të MF, të marra nga departamenti i tatimit në pronë, të arkëtueshme nga tatimi në pronë janë 6,852,822€; dhe
- Në shënimin 35 Komuna e Pejës ka prezantuar të hyra vetjake të pa shpenzuara në fund vitit vlerën prej 648,000€, ndërsa duhet të jetë 699,690€.

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Komuna e Pejës për vitin 2010 kishte *Opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes*. Si çështje e theksuar ishte mungesa e shpalosjes së pasurive dhe raportimi i llogarive të arkëtueshme .

Në raportin tonë të auditimit të PVF të vitit 2010 ishin dhënë tetë (8) rekomandime. Komuna e Pejës kishte përgatitur një Plan Veprimi i cili adreson rekomandimet e dhëna nga ne, për vitin 2010. Gjatë auditimit kemi vërejtur se tri rekomandime ishin adresuar pjesërisht ndërsa pesë rekomandime nuk janë adresuar. Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të dhëna në vitin 2010, ka rezultuar me të njëjtat probleme si në vitin e kaluar.

Për më gjerësisht, shih shtojcën II.

Konkluzioni

Menaxhmenti i komunës së Pejës nuk ka arritur që t'i adresoj rekomandimet tona në nivelin e kërkuar. Deri atëherë, mangësitë e theksuara më lartë do të vazhdojnë të ekzistojnë.

4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Burimet e fondeve dhe shpenzimet

Burimet e fondeve dhe shpenzimet	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Pranimet/ Shpenzimet 2011	Pranimet/ Shpenzimet 2010
I. Gjithsej pranimet/fondet	17,632,988	19,620,792	19,567,453	16,401,953
Granti i Qeverisë -buxheti	15,332,388	15,670,391	15,618,072	12,479,354
Të hyrat e bartura nga viti i kaluar	0	813,111 ¹	813,111	765,624
Të hyrat vetjake të vitit 2011	2,300,600	2,604,370	2,604,370 ²	2,531,742
Donacionet e vendit	0	33,235	32,215	15,228
Donacionet e jashtme	0	499,685	499,685	610,005
II. Gjithsej shpenzimet	17,632,988	19,620,792	18,738,854	15,588,842
Paga dhe Mëditje	9,837,109	10,047,462	10,023,108	8,264,596
Mallra dhe shërbime	1,596,008	2,250,050	2,009,956	1,327,424
Shpenzimet komunale	498,208	511,208	500,349	505,753
Subvencionet dhe transferet	296,156	349,749	328,432	286,867
Investimet Kapitale	5,405,507	6,462,323	5,877,009	5,204,202
Rezervat	0	0	0	0
Diferenca I-II	0	0	828,599	813,111

Sipas të dhënave nga tabela më lartë, shihet se buxheti final për vitin 2011 për komunën e Pejës ka qenë 19,620,792€. Shpenzimet totale për vitin 2011 ishin 18,738,854€, apo rreth 96%.

Nga tabela shihet se buxheti final ishte për 1,987,804€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje ishte për shkak të grantit të qeverisë në vlerë prej 400,000€, (180,000€ për paga dhe mëditje, 190,000€ për mallra dhe shërbime dhe 30,000€ për subvencione dhe transfere). Të hyrat vetjake të inkasuara në 2011 dhe të hyrat e bartura nga viti i kaluar dhe grantet e përcaktuara të donatorëve ishin në vlerë prej 531,902€.

¹ Të hyrat e bartura nga viti 2010

² Të hyrat vetjake të pranuar në vitin 2011

Diferenca prej 828,599€ është e hyrë vetjake e pashfrytëzuar në vlerë prej 699,690€ dhe donacionet e brendshëm të pashfrytëzuar në vlerë prej 128,909€ të cilat janë bartur për shfrytëzim në vitin 2012.

Ne kemi vërejtur tendencën e rritjes së shpenzimeve në fund të vitit financiar. Vetëm në tre mujorin e fundit ishin shpenzuar rreth 39%.

Konkluzion

Komuna e Pejës kishte arritur ta shpenzoj buxhetin brenda parametrave të planifikuar. Por dinamika e shpenzimeve në periudha kohore nuk ishte në pajtim me planin e rrjedhës së keshit, dhe për pasojë, 39% e buxhetit vjetor ishte shpenzuar vetëm në tre muajt e fundit.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Përmirësimin e mëtejshëm të kontrolleve financiare mbi buxhetin, me theks të veçantë alokimet buxhetore sipas tremujorëve dhe kontrollet periodike mbi ecuritë buxhetore.

5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëria me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit

Komuna e Pejës nuk ka arritur të përgatisë PVF sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore.

Pasaktësitë janë identifikuar:

- Te pasqyra financiare 2 Neni 13. *Pasqyra e realizimit të buxhetit*, Komuna e Pejës nuk ka prezantuar saktë të hyrat vetjake. Në këtë pasqyrë komuna ka prezantuar të hyra të realizuar 3,293,000€, ndërsa të hyrat e pranuar të komunës duhet të jenë 2,604,370€;
- Shënimi 15 Të hyrat vetjake nuk është i saktë. Janë prezantuar si të hyra vetjake 2,480,000€ ndërsa duhet të jetë 2,604,370€;
- Po ashtu neni 16 Shpalosja e pasurive Shënimi 30, 32 dhe 34 nuk janë të saktë. Shënimi 30: Përmbledhja e pasurive jo financiare edhe pse është shpalosur vlera prej 6,579,000€ , kjo shumë nuk është e saktë sepse komuna ende nuk është në gjendje të nxjerrë vlerën e tokës, ndërtesave dhe infrastrukturës;
- Ne shënimin 32 Përmbledhja e stoqeve në fund të periudhës, nuk ishte prezantuar asnjë vlerë në PVF;
- Në shënimin 34 Të arkëtueshmet nuk janë prezantuar saktë. Komuna ka prezantuar si të arkëtueshme nga tatimi në pronë vlerën 323,000€ ndërsa sipas raporteve të marra nga departamenti i tatimit në pronë në MF si të arkëtueshme nga tatimi në pronë janë 6,852,822€; dhe
- Neni 17 Shënimi 35 *Bilanci i te hyrave vetjake të pa shpenzuara* nuk është i saktë. Komuna e Pejës ka prezantuar të hyra vetjake të pa shpenzuara në fund vitit në vlerë 648,000€, ndërsa duhet të jenë 699,690€.

Kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare nr.07/2011.

- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 29/01/2012 dhe janë dërguar në MF; dhe
- PVF janë përgatit vetëm në gjuhën shqipe.

Konkluzioni

PVF të Komunës së Pejës përmbajnë gabime të shumta dhe informacionet e prezantuara janë çorientuese. Vlen të përmendet se pasqyrat financiare nëntëmujore ishin të një kualiteti më të mirë, dhe përkundër këshillave të dhëna gjatë auditimit të ndërmjetëm, menaxhmenti nuk kishte arrit t'i hartoj PVF sipas kërkesave raportuese.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Kryetarin që të siguroj se:

- Me rastin e hartimit të PVF, informatat e kërkuara do të prezantohen dhe shpalosen drejt dhe në pajtim me Udhëzimin administrativ të fund vitit; dhe
- Në rast të paqartësive në hartimin e pasqyrave, zyrtarët e komunës duhet të këshillohen me zyrtarët e MF apo të ndjekin trajnime nga kjo fushë, në mënyrë që gabimet e njëjta të mos përsëriten.

6 Menaxhimi Financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2011 ishin 2,300,600€. Gjatë vitit 2011 janë inkasuar 2,604,370€. Gjatë testimit të të hyrave kemi hasur në këto parregullsi:

Tatimi në pronë

Regjistri i pagesave të marra nga baza e të dhënave në MF departamenti i tatimit në pronës kemi vërejtur se është inkasuar shuma prej 747,289€, kurse sipas të dhënave të thesarit janë inkasuar 761,941€. Si rezultat kemi një diferencë prej 14,652€ të regjistruara më tepër në Thesar.

Sipas evidencave të MF/departamenti i tatimit në pronë, borxhi i mbetur i tatimit në pronë më 31 dhjetor 2011 është 6,852,822€, borxh i cili nuk është prezantuar në PVF. Zyrtarëve komunal nuk u është dhënë qasje nga MF/departamenti i tatimit në pronë, të nxjerrin raporte për borxhe të mbetura të tatimpaguesve.

Taksa nga leje ndërtimi

Kemi bërë testimin e 10 (dhjetë) mostrave për lejet e ndërtimit në vlerë të përgjithshme prej 131,793€. Aplikuesit për leje ndërtimi që i kemi testuar nuk kanë ofruar vërtetim se nuk kanë borxhe të pa shlyera ndaj komunës ashtu siç kërkohet me UA nr. 3/2004 dhe urdhëresa e ndalimit të shërbimeve komunale e datës 30.01.2008. Po ashtu, kemi vërejtur se komunës i mungon një bazë e të dhënave ku mund të pasqyrohen qartë të gjitha transaksionet e ngarkesave më taksa dhe pagesa të taksapaguesve të lejeve të ndërtimit në përputhje me standardet e kontabilitetit.

Të hyrat nga taksat e ushtrimit të veprimtarisë afariste të bizneseve

Gjatë testimit të 9 (nëntë) mostrave, kemi identifikuar se Komuna e Pejës nuk ka një bazë të të dhënave gjithëpërfshirëse dhe qartë të taksave për biznese.

Gjatë vitit 2011 Komuna e Pejës nuk i kishte ngarkuar bizneset me vendime për taksa për ushtrimin e afarizmit, siç parashihet me rregullore për tarifa, taksa, ngarkesa, me arsyetimin se rregullorja nuk është certifikuar nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave.

Ne kemi vërejtur se më 10 Maj 2011 Asambleja komunale ka miratuar Rregulloren për tarifa, taksa dhe ngarkesa për implementim dhe këtë e ka dërguar më 5 Shtator 2011 për certifikim në MAPL dhe MF. Sipas deklaratave të zyrtarëve komunal përgjigja e vonuar nga niveli qendror ishte se kjo është ekskluzivisht përgjegjësi e nivelit lokal dhe se organet qendrore nuk bëjnë kesi lloj certifikimesh.

Në fillim të vitit 2012 Komuna e Pejës ka filluar të ju lëshoj vendime bizneseve, që t'i ngarkoj më takës në firmë për vitin 2011 dhe 2012.

Mosdorëzimi i të hyrave vetjake të mbledhura në llogari të komunës

Kemi bërë auditimin e të hyrave vetjake në shkollën e mesme ekonomike dhe teknike. Gjatë auditimit kemi identifikuar se shkolla e mesme ekonomike gjatë vitit 2011 ka organizuar provime, të cilave iu janë nënshtruar 407 kandidatë të rritur. Pagesat në llogari bankare të komunës i kanë bërë 135 kandidatë në shumë prej 34,405€, kurse pagesat për dëftesa në shumën prej 44,632€, në arkën e shkollës kanë bërë 196 kandidatë kurse 76 kandidatë janë të liruar nga pagesa si raste sociale, invalidët e luftës dhe fëmijët e dëshmorëve.

Shuma e parave të inkasuara nga dëftesat në kesh prej 44,632€ dhe teprica e arkës prej 3,455€, e bartur nga 2010, nuk janë inkasuar përmes llogarisë bankare. Këto para ishin përdorur për pagesën e këtyre shpenzimeve: Paga dhe mëditje 31,135€ ku këto shpenzime nuk kishin kaluar përmes sistemit të pagesave (Payroll), po ashtu vetëm shuma 13,650 ishte e aprovuar nga drejtori i shkollës dhe nënshkruar nga mësimdhënësit ndërsa për pjesën tjetër nuk na është ofruar dëshmi se janë aprovuar nga drejtori. Mirëmbajtja e objektit 4,262€, blerja e pajisjeve 2,851€, pagesa e sigurimit 730€, pjesëmarrja në panairë 1,100€, material për zyre 400€ dhe pagesa për koktej për Ditën e shkollës 996€ ishin bërë pa proceduara të prokurimit. Saldo e mbetur në arkën e shkollës ishte 6,612€.

Dhënia e vërtetimeve obliguese të tatimit në pronë pa e paguar borxhin në tërësi

Kemi bërë testimin e 10 (dhjetë) mostrave të dhënies se vërtetimeve obliguese tatimor, nga e cila rezulton se 6 (gjashtë) obligues tatimor kanë marrë vërtetime pa i paguar borxhet e mbetura komunës.

Të hyrat e inkasuara nga dhënia në shfrytëzim e pallatit të sportit

Një pjesë e inkasimit të të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e Pallatit të sportit bëhet me dëftesa të pa ngarkuara nga Komuna e Pejës dhe pa një kontroll adekuat nga drejtoria komunale e sportit dhe kulturës.

Kemi identifikuar se janë inkasuar para kesh edhe mbi 10€ duke ju lëshuar dëftesa si dëshmi për pagesë.

Të hyrat e inkasuar nga shndërrimi i tokës bujqësore në tokë jo bujqësore

Drejtoria për bujqësi, pylltari nuk mban evidenca mbi të hyrat e krijuara nga lëshuarja e vendimeve për shndërrimin e tokës bujqësore në atë jo bujqësore.

Të hyrat nga participimi në shëndetësi

Gjatë testimit të 25 (njëzetë e pesë) mostrave kemi identifikuar se për shërbime stomatologjike dhe çertifikata shëndetësore për patentë shofer, janë inkasuar të hyra në kesh mbi 10€ nga lëshuarja e dëftesave.

Të hyrat nga pëlqimet e lëshuara nga inspektimi për plotësimin e kushteve minimale teknike-sanitare

Kemi bërë testimin e 8 (tetë) motrave të aktvendimeve për plotësimin e kushteve minimale, që rezulton se për lëndën nr. 13-334-4932 e dt. 6/7/2011-prodhim betoni, është llogaritur tarifa prej 200€. Sipas rregullores për tarifa komunale nr. 352-1849 të dt. 10 Maj 2011 Nr. Tarif. 8/2 është paraparë që veprimtaritë prodhuese të paguhet tarifa prej 400€, e jo 200€ siç është ngarkuar obliguesi i taksës.

Konkluzioni:

Komuna e Pejës nuk ka kontrole të mjaftueshme tek të hyrat vetjake. Mosdorëzimi i të hyrave të mbledhura në llogari bankare të komunës dhe shfrytëzimi i tyre jashtë procedurave të kërkuara rrit rrezikun e keqpërdorimit, humbjes së parasë publike dhe shmangies nga pagimi i tatimeve dhe kontributeve. Po ashtu, mungesa e regjistrimit të besueshëm të llogarive për të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste, qiraja nga pasuritë publike, rrit rrezikun që në PVF mos të shpalosen llogaritë e arkëtueshme, por edhe humbjen e kontrollit mbi afatet kohore të inkasimit.

Mosbarazimi i të dhënave në mes të zyrtarit të të hyrave dhe zyrtarëve të drejtorisë së pronës, ndikon në nënvlerësim apo mbivlerësimin e të hyrave vetjake.

Pagesat e bëra në arkë mbi 10€ është në kundërshtim me nenin 11 të Rregullës financiare 03/2010 për të hyrat, ku çdo pagesë mbi 10€ duhet të procedohet përmes bankës.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj:

- Se të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura do të dorëzohen në llogari bankare të komunës;
- Saldoja e mbetur në arkën e shkollës ekonomike (në fund të vitit 2011), në shumë prej 6,612€ të depozitohet në llogarinë bankare të komunës;
- Harmonizimet e duhura të të hyrave vetjake të tatimit në pronë dhe taksave nga departamenti i bujqësisë;
- Se të gjitha pranimet mbi 10€ të bëhen përmes bankës;
- Respektimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale deri sa të çertifikohet rregullorja e re; dhe
- Të bëhet një regjistër gjithëpërfshirës i taksës për ushtrimin e biznese, të lejeve të ndërtimit, taksat për shndërrimin e tokës bujqësore në atë jo bujqësore, qirave nga prona publike, si dhe shtohen kontrollet e inkasimit në pajtim me tarifatat e përcaktuara.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Gjatë vitit 2011, buxheti i ndarë për kategorinë paga dhe mëditje ishte 10,047,462€, kurse ishte shpenzuar shuma prej 10,023,108€. Për të testuar rregullsinë e pagesave dhe procedurat e rekrutimit të personelit, ne kemi përzgjedhur 42 mostra nga personeli dhe kemi vërejtur se komuna nuk ka kontrolle të mjaftueshme në menaxhimin e burimeve njerëzore. Për më gjerësisht, kjo pjesë është e përshkruar në kapitullin e kontrollit të brendshëm.

6.2.2 Prokurimi

Sipas rishikimit analitik shpenzimet për investime kapitale gjatë vitit 2011, ishin 5,877,009€, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin 2,009,956€. Me qëllim të testimit të këtyre shpenzimeve kemi përdor metodën jo statistikore. Ne kemi marrë për testim 71 pagesa për investime kapitale në shumë prej 2,478,379€ apo rreth 42% si dhe 48 pagesa nga kategoria për mallra dhe shërbime në shumë prej 987,937€ apo rreth 49%.

Mungesë e operatorëve të përgjegjshëm

Te lënda "Furnizim me material dentar – stomatologjik për poliklinikën stomatologjike" me vlerë të parashikuar 15,000€ kemi vërejtur se nga tre ofertat e pranuar, vetëm operatori fitues ishte i përgjegjshëm.

Mungesë e fletëdërgesës dhe e raportit të pranimi

Te pagesat në vlerë prej 2,910€ dhe 14,730€, të bëra për furnizim me dru për ngrohje kemi vërejtur se mungon fletëdërgesa dhe raporti i pranimi për furnizimet.

Çertifikimi jo i rregullt i pagesës

Te kontrata "Ndërtimi i rrjetit elektrik në QKMF" të Pejës në vlerë prej 66,017€ kemi vërejtur se mungon raporti i organit mbikëqyrës për të vërtetuar situacionin e punëve të kryera përderisa zyrtari çertifikues kishte çertifikuar lëndën për pagesë.

Konkluzioni:

Rastet e përshkruara me lartë flasin për mangësi të kontrollit të aktiviteteve. Me sa duket, disa nga proceset nuk janë të definuar mirë, si: mbikëqyrja e proceseve, ndarja e detyrave dhe verifikimi. Mungesa e rregullave të brendshme dhe politikave si dhe gabimet në udhëheqjen e procedurave kanë shkaktuar këto dështime edhe në procedurat e kontrollit. Pagesat e bëra pa raporte të organit mbikëqyrës, rrisin rrezikun që pagesat të bëhen edhe për punët që nuk janë kryer fare.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Procedurat e prokurimit janë në pajtim me kërkesat ligjore dhe për të gjitha sasi të furnizuara, ekzistojnë dëshmitë e pranimit; dhe
- Çertifikimi i asnjë pagese nuk do të bëhet, pa u kompletuar dokumentacioni i nevojshëm.

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Për kategorinë e subvencioneve dhe transfere për vitin 2011 ishin ndarë 349,749€, ndërsa nga kjo kategori janë shpenzuar 328,432€ apo rreth 94%. Çështja e parë që kemi vërejtur është se Komuna e Pejës nuk kishte hartuar rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve. Subvencionet ndahen me vendim të kryetarit, pa ndonjë konkurs publik që do të përcaktonte qartë kriteret që duhet të plotësojnë përfituesit. Po ashtu, gjatë testimit të 13 lëndëve nga kjo kategori, është vërejtur se nëntë lëndë nuk ishin të kompletuar me dokumentacionin përkatës si: llogaria bankare, letërnjoftimi, dhe projektet e ofruara.

Ne nuk kemi gjetur se përfituesit e subvencioneve dorëzojnë raporte se mjetet e fituara nga kjo kategori janë shpenzuar në bazë të kërkesës.

Konkluzioni

Mungesa e rregulloreve dhe politikave programore sa i përket menaxhimit të subvencioneve krijon mundësinë që paraja publike të mos jetë shpenzuar për qëllimet e dedikuara dhe objektivat e komunës të mos jenë arritur. Mungesa e raporteve mbi shpenzimet e bëra shton rrezikun që mjetet mos të shfrytëzohen në pajtim me ndarjen e këtyre mjeteve.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se rregullorja për dhënie të subvencioneve të jetë hartuar dhe aprovuar nga Asambleja Komunale;
- Që çdo shpenzim të bëhet vetëm pasi të arrihet kontrata me subjektin përfitues; dhe
- Që çdo përfitues i subvencioneve të raportoj mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve dhe rezultatet e arritura.

6.3 Pasuritë

6.3.1 Trajtimi i të Arkëtueshmeve

Komuna e Pejës nuk kishte evidenca të sakta mbi llogaritë e arkëtueshme. Kështu, llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PVF nga tatimi në pronë ishin 323,000€, ndërsa sipas evidencave të MF, të arkëtueshmet nga tatimit në pronë ishin 6,852,822€.

Të arkëtueshmet nga shitja e pasurisë komunale, nuk janë prezantuar në PVF, ndërsa ekziston obligimi i papaguar i blerësve të pasurisë në vlerë 205,000€.

Konkluzioni

Mungesa e regjistrave për llogaritë e arkëtueshme ndikon që Komuna e Pejës të ketë mungesë të informatave në lidhje me të arkëtueshmet që pret t'i inkasoj gjatë vitit 2011. Kjo ndikon edhe në hartimin e buxheteve vjetore dhe përcaktimin e burimit të fondeve.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Mbjajtjen dhe azhurnimin e regjistrave për llogaritë e arkëtueshme dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për ngritjen e shkallës së inkasimit.

6.3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në vitin 2011 komuna nuk ka arritur të bëjë vlerësimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. Sipas regjistrimit kontabël, vlera e pasurisë fikse ishte regjistruar në shumë prej 6,579,000€. Kjo vlerë nuk përputhet me pasurinë e komunës e cila është e prezantuar në Raportin Vjetor të hartuar nga MF ku vlera neto e pasurisë për Komunën e Pejës është 330,353€. Po ashtu, Komuna e Pejës nuk ka arritur që bëjë regjistrimin e plotë të të gjitha objekteve, tokës dhe infrastrukturës.

Konkluzioni

Edhe përkundër përpjekjeve të Komunës së Pejës, që të regjistroj të gjitha pasuritë me të cilat disponon, kjo nuk është arritur. Prandaj, edhe më tutje mbetet detyrë që të gjitha pasuritë në pronësi komunale të përfshihen në regjistrime.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë:

- Vlerësimin e plotë të pronës, objekteve dhe pajisjeve, në mënyrë që të ketë regjistrin përfundimtar për të gjitha pasuritë që ka nën posedim; dhe
- Të bëjë ruajtjen, shfrytëzimin dhe mbajtjen nën kontroll të pronës publike.

6.3.3 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte në vlerë prej 558,710€. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2012. Ne kemi vërejtur se obligimi ndaj operatorit ekonomik që ka të bëjë me eksproprijimin e ndërtesës banesore afariste në vlerë prej 78,000€, nuk ishte prezantuar në PVF.

Konkluzioni

Mungesa e evidencave të plota dhe prezantimi i pa saktë detyrimeve në PVF, vështirëson edhe hartimin dhe ekzekutimin e buxhetit. Pagesa e obligimeve të pa pritura ndikon në prishjen e bilanceve buxhetore dhe pa mundësinë që buxheti të jetë shpenzuar në pajtim me planifikimin fillestar.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë:

- Se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bën regjistrimin e të gjitha faturave të paguara; dhe
- Shpалosjen e të gjitha obligimeve të papaguara dhe obligimeve të mundshme.

6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Komuna e Pejës kishte dorëzuar raportet tremujore, duke përfshirë edhe Pasqyrat Financiare nëntë mujore me kohë ndërkaq plani final i prokurimit ishte dërguar me kohë.

Komuna kishte përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve për vitin 2010.

7 Kontrolli mbi menaxhimin

7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Në përgjithësi Komuna e Pejës ka një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm, mirëpo nuk ka funksionuar në mënyrë të kënaqshme. Disa nga mangësitë e identifikuara të sistemit janë paraqitur më poshtë.

Edhe më tutje Komuna nuk po arrin që të përgatis PVF në pajtim me kërkesat ligjore. Problemi kryesor të përgatitja e PVF ende mbetet prezantimi i plot i të hyrave vetjake dhe prezantimi i shpalosjeve të duhura.

Po ashtu, Komuna e Pejës ka mungesë kontrollesh mbi të hyrat vetjake. Mungesa e evidencave si dhe mos deponimi i të hyrave vetjake të mbledhura në llogarinë e komunës (rasti i shkollës ekonomike) shton rrezikun që paraja publike të keqpërdoret.

Komuna e Pejës kishte kontrole të pa mjaftueshme edhe të certifikimi i lëndëve për pagesë. Zyrtari certifikues kishte dështuar ta kryej punën e tij në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi. Certifikuesi kishte lejuar pagesa për faturat të cilat nuk kanë qenë në rregull. Rastet ndërlidhen me certifikimin e pagesave pa dokumentacionin përkatës, si për investime kapitale ashtu edhe për subvencione.

Ndonëse vitin e kaluar ishin dhënë rekomandime të qarta për subvencionet, asnjë veprim përmirësimi nuk ishte ndërmarrë. Mungesa e rregullores së brendshme për subvencione rezulton edhe më tutje me dhënien e subvencioneve pa projekte të qarta, pa marrëveshje mirëkuptimi dhe mungesë raportimi.

Në fushën e personelit kemi vërejtur se dosjet e zyrtarëve nuk janë azhurnuar mirë; disa zyrtarëve u mungon formulari i vlerësimit, kopja e letërnjoftimit, kopja e llogarisë bankare dhe përshkrimi i vendit të punës, si kërkohet me rregulloren Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civil.

Një problem tjetër është edhe regjistrimi i pasurive, i cili duket se do të jetë i pranishëm edhe për një kohë të gjatë. Komuna posedon shumë prona të cilat nuk ka arritur t'i regjistroj dhe natyrisht t'i menaxhoj në mënyrën e duhur.

Konkluzioni

Sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon vendosje të udhëzimeve dhe procedurave të qarta të kontrolleve. Në formën aktuale, kontrollet e brendshme nuk ofrojnë sigurinë e duhur se objektivat e përcaktuara komunës po arrihen, ndonëse vërehet progres në krahasim me vitin e kaluar.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Rishikimin e sistemit aktual të kontrollit të brendshëm dhe aty ku janë identifikuar dështimet, të nxirren politika dhe procedura specifike me qëllim përmirësimi të kontrolleve.

7.2 Auditimi i Brendshëm

Gjatë auditimit të NJAB në Komunën e Pejës është konstatuar se kjo njësi funksionon me tre auditor, disponon planin strategjik dhe vjetor të auditimit, i cili ka përfshirë fushat me rrezik të lartë. NJAB në Komunës e Pejës ka arritur të kryej auditime në pajtim me standardet mbi auditimin e brendshëm. Vlerësimi ynë është se raportet ishin mjaft cilësore dhe menaxhmentit i ofrojnë pasqyrë të mirë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre. Po ashtu, është vërejtur se NJAB kishte përcjellur zbatimin e rekomandimeve. Adresimi i rekomandimeve ishte trajtuar mirë nga menaxhmenti i Komunës.

Komuna e Pejës nuk e ka të themeluar komitetin e auditimit që i ndihmon NJAB në arritjen e objektivave dhe shtimin e sigurisë menaxhmentit në proceset qeverisjes.

Konkluzioni

Komiteti i auditimit paraqet një mekanizëm të fortë në mbështetjen e NJAB, mbikëqyrjen e menaxhimit efikas dhe efektiv të Komunës së Pejës, adresimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe ndihmon menaxhmentin në proceset e qeverisjes dhe vendimmarrjes.

Rekomandimi 10

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Themelimin e Komitetit të auditimit, në mënyrë që rritë mbikëqyrjen efikase, efektive dhe ekonomike të Komunës.

8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Pejës

Konkluzionet e përgjithshme

Komuna e Pejës nuk ka arrit të ndërtoj një strukturë të konsoliduar të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi. Ne duhet të theksojmë faktin se komuna në dy vitet e fundit nuk ka adresuar asnjë nga rekomandimet tona dhe ne jemi të brengosur për një qasje të tillë. Menaxhmenti i komunës duhet të zhvilloj një qëndrim më pozitiv ndaj kontrolleve të brendshme të organizatës.

Është e pa qartë nëse menaxhmenti nuk e kupton rëndësinë e çështjeve të dala nga auditimi apo nuk ka gatishmëri për t'i trajtuar ato në mënyrën e duhur.

Marrë në përgjithësi, hallka më e dobët e sistemit të MF/K mbetet menaxhimi i të hyrave. Mos barazimet e të hyrave me thesarin, gjendja e paqartë e tatimeve në pronë, mos ngarkesat e bizneseve me taksa, inkasimet dhe shpenzimet direkte në kesh dhe inkasimet jo në pajtim me tarifën e përcaktuara, janë vetëm disa nga mangësitë e menaxhimit me të hyrat.

Monitorimi i mbledhjes dhe raportimit të të hyrave është i pa mjaftueshëm. Në mungesë të informatave të pa mjaftueshme, nuk është i mundur as hartimi i një buxheti të qëndrueshëm. Prandaj, obligimet ndaj raportimeve të rregullta dhe të besueshme, duhet të jenë pjesë e përditshme e aktiviteteve për të gjithë. Aftësitë e stafit dhe përvoja e tyre duhet të jenë pikënisje për ndarjen e detyrave dhe dhënien e përgjegjësive. Trajnimet e rregullta dhe promovimet në baza të performancës, po ashtu duhet të praktikohen.

Mesazhi ynë kryesor është se forcimi i komponentëve të KBFP-së, ku përfshihen menaxhimi financiar dhe kontrolli, si dhe auditimi i brendshëm, duhet të jenë objektiva të përhershme të menaxhmentit. Ato duhet të shtrihen në tërë organizatën, dhe secili duhet të ndiej obligimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);

b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinionin në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II. Rekomandimet e vitit të kaluar

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
5.2 Cilësia e informatave në PVF	Përgatitja e PVF në pajtim me kërkesat ligjore duke i përfshirë të gjitha shpalosjet.			X
6.1 Të hyrat vetjake	Harmonizimet i të hyrave si dhe mbajtja e rexhistrave dhe regjistrimi në kodin e duhur.		Është bërë harmonizimi ndërsa ende mungojnë regjistrat për të hyrat	
6.2.1 Blerjet përmes prokurimit	Të gjitha pagesat do të bëhen në pajtim me kontratën. Sigurimi i mjeteve para lidhjes së kontratës dhe punët të kryhen në harmoni me planin dinamik.		Të gjitha pagesat ishin në pajtim me kontratën ndërsa ende ka vonesa në realizimin e punimeve.	
6.3 Subvencionet dhe transferet	Hartimi i rregullores për subvencione dhe respektimi i kriterëve në dhënien e			X

	subvencioneve			
6.4.1 Pasurit kapitale dhe jokapitale	Rexhistrimi i plotë i pasurive komunale.			X
6.4.2 Borxhet	Rexhistrimi i faturave të paguara dhe të pa paguara			X
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshme	Marrja e masave të duhura për t'u siguruar se rivendosja e kontrolleve siguron eliminimin e të gjitha dobësive.		x	
7.2 Auditimi i brendshëm	Kryej auditime periodike për periudhën brenda vitit vijues dhe formimi i komitetit të auditimit.			X
Totali	8	0	3	5